



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:128892

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06605647

C.nr.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Haxhi Xhemajli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, K.T, dega në Pejë, rr. ..., të cilën e përfaqëson i autorizuari ..., kundër të paditurit, B.G, nga Peja, rr. ..., me objekt kontesti: pagimin e borxhit nga marrëveshja për kredinë, vlera e kontestit: ... euro, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të të paditurit, në seancën e shqyrtimit kryesor, me datë 11.12.2024 mori, ndërsa e përpiloi me datë 16.12.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit: K.T., dega në Pejë, rr. ..., dhe DETYROHET i padituri B.G, nga Peja, rr. ..., që paditësit t'ia paguaj në emër të borxhit, shumën prej ... euro, me kamat ligjore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë me datë ..., e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 221 euro, të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, K.P., në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë ..., me objekt kontesti, pagimin e borxhit nga marrëveshja për kredinë, dhe me vlerë të kontestit ... Euro.

Pala paditëse përmes të autorizuarit së saj, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe precizimit të saj me datë ..., duke kërkuar që të DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj në emër të borxhit, shumën prej ... euro, me kamat ligjore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë me datë ..., e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 221 euro, të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm, duke theksuar se, me provat e administruara është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditësit, dhe duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të APROVOHET në tërësi si e bazuar.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike kontestimore është mbajtur në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, i cili mungesën nuk e ka arsyetuar. Prandaj, gjykata duke marr për bazë nenin 423 paragrafi 4 të LPK, si dhe propozimin e të autorizuarit të palës paditëse, vendosi që shqyrtimi kryesor të mbahet në mungesë të palës së paditur.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Marrëveshjen për kredinë me numër ..., e datës ...; Plani i pagesave të kredisë, i datës ...; Njoftimi i fundit për mos përmbushjen e obligimeve (pagesave) sipas kontratës se kredisë i datës ...; dhe ekspertiza financiare e datës ...

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim: LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se, paditësi dhe i padituri me datë ..., kanë hyrë në raport juridik detyrimor, nga i cili raport është krijuar detyrimi për të paditurin për kthimin e borxhit në kohëzgjatje prej 12 muaj. Një fakt të tillë gjykata e provoj përmes marrëveshjes për kredinë të lidhur në mes paditësit dhe të paditurit me datë ...

Në bazë të planit të pagesave të kredisë, të datës ..., gjykata konstatoj faktin se i padituri ka qenë i detyruar për kthimin e kredisë sipas planit të derivuar në bazë të marrëveshjes për kredinë nr. ..., në shumë totale prej ... euro.

Në bazë të njoftimit të fundit për mos përmbushjen e obligimeve (pagesave) sipas kontratës se kredisë, gjykata provoj faktin se i padituri në cilësinë e huamarrësit nuk i është përmbajtur detyrimeve nga marrëveshja për kredinë, përkatësisht i njëjti është njoftuar nga huadhënësi për detyrimin rreth përmbushjes se menjëhershme të detyrimit të tillë ndaj huadhënësit.

Në bazë të ekspertizës financiare të datës ..., gjykata provoj faktin se borxhi i mbetur i të paditurit ndaj paditësit – kredidhënësit është në shumën totale prej ... euro. Gjykata e ka pranuar ekspertizën e ekspertit financiar në tërësi si të besueshme, për faktin se njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar. Nisur nga ky konstatim, kreditori në këtë marrëdhënie të detyrimit, ka të drejtë që prej debitorit - të paditurit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka pas për detyrë ta përmbushë atë detyrim, dhe atë duke iu përmbajtur kushteve dhe afateve të përcaktuara në raportin juridik detyrimor – marrëveshjen për kredinë.

Pra, baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjës për kthimin e borxhit ndaj paditësit gjënë mbështetje në nenin 245 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD). Në bazë të nenit 245 paragrafi 1 të LMD përcaktohet se, *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në*

përputhje me përmbajtjen e tij.” Sipas përmbajtjes se kësaj norme, i padituri ka qenë i detyruar që detyrimin ndaj paditësit ta përmbush me ndërgjegje dhe në tërësi, dhe atë duke respektuar parimin e ndërgjegjshmerisë, i cili parim përcakton detyrimin e palëve kontraktuese dhe gatishmërinë e tyre që në kohë të caktuar dhe në mënyrë vullnetare t’i përmbushin detyrimet e tyre, pra sipas përmbajtjes se marrëveshjes se tyre. Me konkretisht, neni 4 i LMD përcakton se, *“Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.”* Në këtë rast, i padituri me veprimet e tij është dashur të tregoj gatishmëri që në mënyrë vullnetare të përmbush detyrimin i cili ka rrjedh si rezultat i marrëveshjes se kredisë të lidhur me palën paditëse. Mirëpo, meqenëse i padituri ka vepruar në kundërshtim me parimin e theksuar, rrjedhimisht ka ardhur deri të rënia në vonesë, dhe njëkohësisht paraqitja e të drejtës së paditësit për të kërkuar përmbushjen e borxhit. Pra, nga ky përcaktim ligjor rrjedh konkludimi se, paditësi ka të drejtë të kërkojë nga i padituri kthimin e shumës së marrë të kredisë sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe atë duke përfshirë kamatën e kontraktuar dhe kamatëvonesën.

Për me tepër, në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata vërtetoi faktin se ekziston detyrimi juridik – civil ndaj paditësit për kthimin e borxhit në emër të kredisë, në shumën prej ... euro, mirëpo nga provat prezente në shkresat e lëndës, edhe pse i padituri ka hyrë në këtë raport të detyrimit - kontraktues me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit, prapëseprapë i njëjti nuk i është përmbajtur detyrimit të tij, në mënyrë që të kthejë shumën e plotë të borxhit.

Gjykata po ashtu vlerëson se, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të LPK, palët kanë për detyrë t’i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas nenit 319 paragrafi 1 të LPK, përcaktohet se secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në këtë rast, meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar të kundërtën e borxhit të pretenduar, gjykata e vënë para një situatë të tillë, dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik – civil i të paditurit ndaj paditësit për kthimin e borxhit, në shumën prej Me saktësisht, i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin në përputhje me përmbajtjen e tij, dhe ka rezultuar se i njëjti i ka paguar vetëm 4 (katër) këste të kredisë, kurse nuk ka paguar edhe pjesën e mbetur të detyrimit i cili përfshin 8 (tetë) këste të kredisë, në shumën e përgjithshme prej ... euro.

Sa i përket vendimit lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD, dhe paragrafin X (dhjetë) të Mendimit Juridik për Kamatën nr. 265/2020 të datës 01.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke ju referuar datës së parashtrimit të padisë, përkatësisht datës 27.12.2018.

Lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata ka marr për bazë nenin 463 paragrafi 1 i LPK i cili përcakton se, *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë*

vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.” Një detyrim të tillë pala e cila kërkon t’i njihen shpenzimet e procedurës e ka edhe në bazë të paragrafit 2 të të njëjtit nen, i cili parasheh se, *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.”* Në këtë rast, i autorizuari i palës paditëse ka parashtruar kërkesë të specifikuar për shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës, duke kërkuar për ekspertizën e hartuar shumë prej 200 euro, si dhe shumë prej 21 euro për taksen gjyqësore për padinë e parashtruar në gjykatë, të cilat gjykata i aprovoj në shumë e përgjithshme prej 221 euro.

Nga arsyet e theksuara më lartë, duke u bazuar në nenin 4, 245 paragrafi 1 të LMD, si dhe në harmoni me nenin 143 paragrafi 1, dhe nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:128892, C.nr.; datë 16.12.2024

Gjyqtari

Haxhi Xhemajli

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.